



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2023

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Data 23/03/2023

Drejtuar: Bashkimit te Operatoreve Ekonomike “XHAŠT” SH.P.K & “ARKONSTUDIO” SH.P.K, perfaqesuar nga OE “XHAŠT” SH.P.K, me adrese Golem, Kavaje, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur/ Pune.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-60324-02-24-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksioni i pallatit Nr. 21 dhe godines se ish-bankes se shtetit”.

Kohëzgjatja e kontratës: 3 Muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori ekonomik “ASI-2A CO” SH.P.K, me Nuis K53002402C dhe me oferte ekonomike 15,000,000 (pesembedhjete milion) Lek pa TVSH,
- 2- Operatori ekonomik “EURO-ALB” SH.P.K, me Nuis K66613407H dhe me oferte ekonomike 13,846,052 (trembedhjete milion e teteqind e dyzet e gjashte mije e pesedhjete e dy) Lek pa TVSH,
- 3- Operatori ekonomike “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SH.P.K, me Nuis K81314023A dhe me oferte ekonomike 14,715,971 (katermbedhjete milion e shtateqind e pesembedhjete mije e nenteqind e shtatedhjete e nje) Lek pa TVSH,
- 4- Bashkimi i operatoreve ekonomike “XHAŠT” SH.P.K, me Nuis K12512837I & “ARKONSTUDIO” SH.P.K, me Nuis L42019004I dhe me oferte ekonomike 16,505,082.80 (gjashtembedhjete milion e peseqind e pese mije e tetedhjete e dy pike tetedhjete) Lek pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori ekonomik “ASI-2A CO” SH.P.K, me Nuis K53002402C,

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se: Operatori ekonomik ka paraqitur ofertën me vlerë me të lartë se fondi limit për rikonstruksionin e godinës së ish-bankës së shtetit.

KVO verën se fondi limit për procedurën e prokurimit është 16,666,601.64 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një *pike* gjashtëdhjetë e kater) Lek pa TVSH, nga keto:

- Fondi limit për Rikonstruksionin e pallatit Nr. 21 është **13,333,330.64** (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë pike gjashtëdhjetë e kater) Lek pa TVSH.

- **Fondi limit për Rikonstruksionin e godinës së ish-bankës së shtetit është 3,333,271 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë) Lek pa TVSH.**

Po ashtu KVO verën se duke qenë se objekti i prokurimit përfshin rikonstruksionin e dy godinave për të cilat janë vënë në dispozicion fonde të veçanta për secilin, AK-ja ka përcaktuar në DST fondet limit për secilin nga keto objekte.

Nga verifikimi i formularit të ofertes ekonomike të paraqitur në SPE nga ky operator ekonomik vërehet se për rikonstruksionin e godinës së ish-bankës së shtetit, ka paraqitur oferte ekonomike me vlerë **4,688,650** lek pa TVSH e cila rezulton mbi fondin limit të parashikuar për këto objekte.

KVO mban në konsideratë se Këshilli i Bashkisë Lezhë ka vënë në dispozicion me anë të vendimit nr. 120, datë 02/12/2022 “Për Miratimin e Buxhetit për vitin 2023 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, një fond të përcaktuar prej **3,333,271** lek pa TVSH për “Rikonstruksionin e godinës së ish-bankës së shtetit” dhe ky informacion është pasqyruar në DST-ne e kësaj procedure prokurimi të seksionit ku pasqyrohet fondi limit.

Për sa më lart operatori ekonomik ka paraqitur oferte ekonomike mbi fondin limit për një nga objektet e kërkuar dhe rrjedhimisht duke qenë se është mbi fondin limit në dispozicion kjo oferte refuzohet.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nënën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një

standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ASI-2A CO” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ASI-2A CO” SH.P.K, me Nuis K53002402C, skualifikohet.

II- Operatori ekonomik “EURO-ALB” SH.P.K, me Nuis K66613407H

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.5 ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si me poshte:

- Teknik Ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektronik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Suvatues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Plakashtues	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Bojaxhi	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidroizolues	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	5 (pese)	Leje Drejtimi

Operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome e shkolles mesme/ Çertifikate trajnimi/ Deshmitë profesionale/Leje Drejtimi, sipas shënimeve për çdo kategori të mesiperm si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Nentor 2022 - Janar 2023.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimit”.

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për te përmbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin përmbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit teknik, mbeshtetes dhe te çertifikuar qe disponon sipas percaktimeve te DST-se.*

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE ka deklaruar ne formularin përmbledhes te vetedeklarimit disponimin e stafit mbeshtetes sipas kriterit 2.3.5 te DST-se, por nga verifikimi i listepagesave te paraqitur ne SPE nga ky operator ekonomik rezulton se V. Marku i deklaruar si teknik ndertimi si dhe S. Dauti dhe R. Tani te deklaruar si teknik elektronik nuk figurojne ne listpagesat e shoqerise per periudhen Nentor 2022 - Janar 2023.

KVO gjykon se megjithese ky OE ka deklaruar ne formularin përmbledhes te vetedeklarimit disponimin e V. Marku te punesuar si teknik ndertimi, si dhe S. Dauti dhe R. Tani te punesuar si teknik elektronik, si dhe duke qene se ka bashkengjitur ne SPE listpagesat e shoqerise per periudhen Nentor 2022 - Janar 2023, verehet se OE nuk ka pasur si qellim per te bere deklarim te rreme me qellim kualifikimi.

Per sa me siper KVO veren se ky OE nuk disponon ne listpagesat e shoqerise per periudhen Nentor 2022 – Janar 2023, nje teknik ndertimi nga dy te kerkuar, si dhe nuk disponon nje teknik elektronik te kerkuar ne piken 2.3.5 te DST-se.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.7 te DST-se ku parashikohet se: *“Operatorët Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:*

<i>Nr</i>	<i>Lloji i makinerive</i>	<i>Pronësia</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>cope</i>	<i>2</i>
2	<i>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes nga 5 deri ne 10 ton</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>cope</i>	<i>2</i>
3	<i>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 12-18 ton</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>
4	<i>Autobetoniere</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>
5	<i>Skeleri</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>m2</i>	<i>1500</i>
6	<i>Betoniere kantieri</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>cope</i>	<i>2</i>

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit: - çertifikaten e pronesisë; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa për mjete të marra me qera/kontrate bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatëse, ndersa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave/ Kontrate Bashkëpunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

KVO verën se bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatëse të DST-se, të dhënat e mjeteve që disponon sipas përcaktimeve të pikës 2.3.7 të DST-se.*

Nga verifikimi në SPE, rezulton se ky OE ka deklaruar saktë vetëm disponimin e 2 mjeteve “Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 12-18 ton”, “autobetoniere” dhe “dy betoniere kantieri”, por nuk ka deklaruar saktë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit disponimin e mjeteve të tjera sipas kriterit 2.3.5 të DST-se, pasi nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetedeklarimit vërehet se ka deklaruar disponimin e mjeteve kamioncine 5 cope, kamion 4 cope dhe Skela.

KVO verën se në deklarinë e OE-se, në formularin përmbledhës të vetedeklarimit nuk përcaktohet kapaciteti mbajtes i kamioneve apo kamionçinave.

Po ashtu KVO verën se në deklarinë e OE-se në formularin përmbledhës të vetedeklarimit nuk përcaktohet sasia e skelave, pasi ky OE nuk ka deklaruar disponimin e 1500 m² skeleri të kerkuar në pikën 2.3.7 të DST-se.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një

kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “EURO-ALB” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “EURO-ALB” SH.P.K, me Nuis K66613407H, skualifikohet.

III- Operatori ekonomike “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SH.P.K, ME NUIS K81314023A

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se:

Se pari, operatori ekonomik ka paraqitur ofertën me vlerë me të lartë se fondi limit për Rikonstruksionin e godinës së ish-bankës së shtetit.

KVO verën se fondi limit për procedurën e prokurimit është 16,666,601.64 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një *pikë* gjashtëdhjetë e katër) Lek pa TVSH, nga keto:

- Fondi limit për Rikonstruksionin e pallatit Nr. 21 është 13,333,330.64 (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë pikë gjashtëdhjetë e katër) Lek pa TVSH.
- **Fondi limit për Rikonstruksionin e godinës së ish-bankës së shtetit është 3,333,271** (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë) Lek pa TVSH.

Po ashtu KVO verën se AK-ja duke qenë se objekti i prokurimit përfshin rikonstruksionin e dy godinave të cilat për rikonstruksionin e tyre kanë në dispozicion fonde të veçanta për secilin, ka përcaktuar në DST fondet limit për secilin nga objektet.

Nga verifikimi i formularit te ofertes ekonomike te paraqitur ne SPE nga ky operator ekonomik verehet se per rikonstruksionin e godines se ish-bankes se shtetit, ka paraqitur oferte ekonomike me vlere **3,378,910** lek pa TVSH e cila rezulton mbi fondin limit per kete objekt.

KVO mban ne konsiderate se Keshilli i Bashkise Lezhe ka vene ne dispozicion me ane te vendimit nr. 120, date Datë 02/12/2022 të Këshillit Bashkiak Lezhë “Per Miratimin e Buxhetit per vitin 2023 dhe te Programit Buxhetor Afatmesem 2023-2025”, nje fond te percaktuar prej **3,333,271** lek pa TVSH per “Rikonstruksioni i godines se ish-bankes se shtetit” dhe ky informacion eshte pasqyruar ne DST-ne e kesaj procedure prokurimi te seksioni ku pasqyrohet fondi limit.

Per sa me lart operatori ekonomik ka paraqitur oferte ekonomike mbi fondin limit per nje nga objektet e kerkuar dhe rrjedhimisht duke qene se kjo oferte eshte mbi fondin limit ne dispozicion refuzohet.

Se dyti, nuk permbush kriterin 2.3.5, ku parashikohet se: “*Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*

- Teknik Ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektronik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Suvatues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Plakashtues	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Bojaxhi	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidroizolues	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	5 (pese)	Leje Drejtimi

Operatori ekonomik duhet te paraqese per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome e shkolles mesme/ Çertifikate trajnimi/ Deshmitë profesionale/Leje Drejtimi, sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Nentor 2022 - Janar 2023.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit”.

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin*

permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit teknik, mbeshtetes dhe te certifikuar qe disponon sipas percaktimeve te DST-se.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit disponimin e 5 shoferave sipas kriterit 2.3.5 te DST-se.

KVO veren se ky operator ka paraqitur ne SPE informacion mbi subjektin, mbi kapacitetin e te cilit do te mbeshtetet per piken 2.3.5, per shoferat.

Ndersa nga verifikimi i DST-se ne seksionin 2.16 parashikohet se;

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

Nuk lejohet mbeshtetja ne kapacitetet e subjekteve te tjera per pembushjen e kriterëve te vecanta te pikave 2.3.4; 2.3.5 dhe 2.3.6.

KVO konstaton se autoriteti kontraktor nuk lejon per kete procedure prokurimi mbeshtetje ne kapacitetet e subjekteve te tjera per pembushjen e kriterëve te vecanta te pikave 2.3.4; 2.3.5 dhe 2.3.6.

Per sa me lart duke qene se operatori ekonomik nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit disponimin e 5 shoferave, si dhe duke qene se ne DST, nuk lejohet mbeshtetje ne kapacitetet e subjekteve te tjera per pembushjen e kriterëve te vecanta te pikave 2.3.4; 2.3.5 dhe 2.3.6 ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve

ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SH.P.K, me Nuis , me Nuis K81314023A, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “XHAST” SH.P.K & “ARKONSTUDIO” SH.P.K, përfaqësuar nga OE “XHAST” SH.P.K, me adrese Golem, Kavaje, Tirane se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 16,505,082.80 (gjashtembdhjete milion e pesëqind e pese mije e tetëdhjete e dy pike tetëdhjete) Lek pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

Pjerin NDREU